



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 164 Prot.

Datë 28.3.2022

V E N D I M

Nr. 3, datë 28.3.2022

Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Elsa Toska,	Anëtare
Altin Binaj,	Anëtar
Përparim Kalo,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

Me vendimin nr. 1, datë 11.01.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të nenit 13, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendosi caktimin e përbërjes së tri kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese për vitin kalendarik 2022.

Bazuar në nenin 125, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në datën 15.03.2022 zgjodhi gjyqtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese, zotin Sandër Beci, i cili në datën 23.03.2022 bëri betimin para Presidentit të Republikës.

Në përputhje me nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.

Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me kompetencën e parashikuar në nenin 13, shkronja "e", të ligjit të saj organik, si dhe bazuar në nenin 22 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 1, datë 11.01.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në këtë mënyrë:

Kolegji 1: Kryesuese Marsida Xhaferllari
 Anëtare Elsa Toska
 Anëtar Sandër Beci

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARE

/Fiona Papajorgji/

ANËTARE

/Marsida Xhaferllari/



ANËTAR

/Përparim Kalo/

ANËTAR

/Altin Binaj/

ANËTARE

/Elsa Toska/

ANËTAR

/Sandër Beci/

ANËTARE

/Sonila Bejtja/